



Ne baze te neneve 12, paragrafi 2, shkronja (c), nenit 17 dhe 30, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28/2008), nenin 11, 27, 28 dhe 29, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 10, të Rregullores për procedurat e ndarjes së çmimit, Ukë Bytyçi, 01-Nr-16-5820, të datës 29.09.2011, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

V E N D I M
Për emërimin e komisionit

Neni 1

Emërohet komisioni për pranimin dhe shqyrtimin e propozimeve që vijën nga ana e Kryetarit të Komunës, institucionet shtetërore dhe publike, organizatat (shoqata) qeveritare dhe jo qeveritare, kryesit e fshatrave dhe çdo qytetar i Komunës së Suharekës, për ndarjen e çmimit Ukë Bytyçi, me këtë përbërje:

- 1.1 -----kryesues
- 1.2 -----anëtar
- 1.3 -----anëtar
- 1.4 -----përfaqësuese i ekzekutivit
- 1.5 -----përfaqësuese i shoqërisë civile

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që të bëjë shqyrtimin e propozimeve që vijnë nga Kryetari i Komunës, institucionet shtetërore dhe publike, organizatat (shoqata) qeveritare dhe jo qeveritare, kryesit e fshatrave dhe çdo qytetar i Komunës së Suharekës, bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës për themelimin e çmimit, Ukë Bytyçi, me numër, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011 dhe rregullores për procedurat e ndarjes së çmimit, Ukë Bytyçi, me numër, 01-Nr-16-5820, dhe pas shqyrtimit të të gjitha propozimeve njërin nga të propozuarit ja rekomandon Kuvendit të Komunës për të vendosur dhe për ta shpallur fitues.

Neni 3

3.1 Mandat i anëtareve të Komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____

Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI